# DËSHMI ARKIVI

**A-457554**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tenderi 43 milionë lekë i KQZ-së nën pikëpyetje: Kompania e vëllait të Ferit Hoxhës fiton sërish, çfarë nd odhi me sistemin? |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/kompania-e-vellait-te-ferit-hoxhes-fituese-edhe-me-pare-nderhyrja-ne-si-i104986` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 11:25:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 11:19:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ba8d50508c788bf8761d4e34a52800f3aeb6374f885afe62ce7fe6b881a9c08d` |
| TEKSTI | `17354c572d73519656120c083e0c86de76037b028f683f1b48bd9ef12e40d7cc` |
| PAMJA | `e8d98bb1b1d490152694dff31348da77dbf447951c68437699a9e3518c6c5836` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c479eadbf770873f230fcc0acc1258a7675779f6626e4736a30b0587a4366a61` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c479eadbf770873f230fcc0acc1258a7675779f6626e4736a30b0587a4366a61`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Tenderi 43 milionë lekë i KQZ-së nën pikëpyetje: Kompania e vëllait të Ferit Hoxhës fiton sërish, çfarë ndodhi me sistemin?

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 13:19

eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike (*SPE*) Komisioni konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi përbëhet nga 3 (*tre*) anëtarë dhe konkretisht znj.

4

Daniela Alimemeti, z. Redion Lila dhe znj. Fatjona Sulaj, të cilët kanë rivlerësuar me pikë përkatësisht ofertën e operatorit ekonomik ofertues *"INSTANT.AL"* SHPK, ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "*INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK*" dhe ofertën e operatorit ekonomik *"Evolve Web Studio"* SHPK sipas vlerësimit të bërë nga po ky komision në datën 16.12.2025, referuar shkresës nr. 48/4 prot, datë 26.01.2026 "*Përcjellje vendimi të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*" protokolluar me tonën me numër protokolli nr. 107/3 prot, datë 27.01.2026, ndërkohë që konstatohet se ofertat e sipërpërmendura janë rivlerësuar edhe nga një person tjetër pranë autoritetit kontraktor me username "*Jonakqz Josifi*" (*e cila nuk është anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*), e cila ka rivlerësuar me 0 (*zero*) pikë çmimin e ofertës dhe propozimin teknik të operatorit ekonomik ofertues *"INSTANT.AL"* SHPK dhe operatorit ekonomik *"Evolve Web Studio"* SHPK, ndërsa oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë "*INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK*" është rivlerësuar me pikët maksimale për 5 (pesë) kriteret e përzgjedhjes së ofetës fituese të përcaktuara në pikën 4.4 "*Kriteret e përzgjedhjes së fituesit*" të Seksionit 4 "*Procedura*" të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit të rivlerësuar. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se, për rivlerësimin me pikë të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "*INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK*", autoriteti kontraktor duhet të lexojë me vëmëndje interpretimet e Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin Nr. 227/2026, datë 10.02.2026, duke ju referuar bazën ligjore, duke ju referuar vlerësimit me pikë të bërë nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në datën 16.12.2025, referuar shkresës nr. 48/4 prot, datë 26.01.2026 "*Përcjellje vendimi të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*" protokolluar me tonën me numër protokolli nr. 107/3 prot, datë 27.01.2026, si dhe çdo referencë tjetër të cituar në këtë vendim.

Tenderi 43 milionë lekësh i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike nuk duket më si një episod i izoluar prokurimi. Sa më shumë hapen dokumentet, aq më shumë historia shkon përtej një gare ku dy ofertues më të lirë u nxorën jashtë loje dhe në fund mbeti në këmbë bashkimi i kompanive me ofertën më të shtrenjtë.

Në qendër të kësaj historie është bashkimi i operatorëve INTELISOFT–WOW DIGITAL. INTELISOFT është në pronësi të biznesmenit Gëzim Hoxha, vëllait të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha. Emri i Hoxhës dhe i kompanisë tjetër të tij, "FIRST", është përmendur më herët në raportimet mbi dosjen e AKSHI-t dhe tenderët publikë në fushën e teknologjisë.

Por zhvillimi i ri e bën panoramën më të rëndë. Të dhënat publike tregojnë se i njëjti bashkim operatorësh, INTELISOFT–WOW DIGITAL, kishte fituar edhe më parë kontrata në KQZ, para tenderit të kontestuar të vitit 2025.

Vetëm gjatë vitit 2024, ky bashkim kompanish rezulton fitues në tre kontrata të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në shtator 2024, INTELISOFT–WOW DIGITAL u shpall fitues me rreth 9.8 milionë lekë për krijimin e moduleve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese.

Në nëntor të po atij viti, fitoi një tjetër kontratë me vlerë 5.8 milionë lekë për mirëmbajtjen e moduleve gjatë periudhës zgjedhore.

Ndërsa në dhjetor 2024, rezulton fitues edhe në një kontratë tjetër me vlerë 2.8 milionë lekë për modulin e raportimit në kohë reale të aktiviteteve publike.

Të treja këto kontrata të mëparshme, janë dhënë në mungesë të garës. Ndërsa në këtë të fundit u tentua të kishte garë mes kompanishë, por KQZ edhe në këtë rast zgjodhi të ndërhynte për ta cenuar konkurrencën.

Pra, kur KQZ hapi tenderin e ri për "Mirëmbajtjen e moduleve ekzistuese", INTELISOFT dhe WOW DIGITAL nuk ishin emra të panjohur për institucionin. Ato kishin punuar tashmë me modulet e KQZ-së dhe kishin fituar disa kontrata brenda një periudhe të shkurtër.

Pikërisht kjo histori kontratash e bën edhe më të rëndësishme pyetjen nëse procedura e radhës po shkonte sërish drejt të njëjtëve operatorë. Dyshimet forcohen nga mënyra si u zhvillua gara dhe

sidomos nga ndërhyrja në sistem e një zyrtareje që nuk ishte pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Në tenderin me fond limit 42.97 milionë lekë pa TVSH, “EVOLVE WEB STUDIO” paraqiti ofertë rreth 33 milionë lekë, “INSTANT.AL” rreth 33.7 milionë lekë, ndërsa bashkimi INTELISOFT–WOW DIGITAL paraqiti ofertën më të lartë, rreth 40.82 milionë lekë. Megjithatë, dy ofertat më të lira u skualifikuan dhe në garë mbeti bashkimi me çmimin më të lartë.

Dokumentet e Komisionit të Prokurimit Publik nxjerrin në pah një element kyç: gjatë fazës së rivlerësimit në sistem shfaqet përdoruesi “Jonakqz Josifi”, i lidhur me Jona Josifin, në atë kohë Sekretare e Përgjithshme e komanduar e KQZ-së. Josifi nuk ishte pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i cili përbëhej nga Daniela Alimemeti, Redion Lila dhe Fatjona Sulaj.

Sipas konstatimeve të evidentuara në procedurë, nga ky përdorues rezultojnë veprime në rivlerësimin e ofertave. Dy operatorët me çmimet më të ulëta, “INSTANT.AL” dhe “EVOLVE WEB STUDIO”, u vlerësuan me zero pikë në kriteret teknike, ndërsa INTELISOFT–WOW DIGITAL mori pikët maksimale. Me pak fjalë, në njërin krah zero, në krahun tjetër maksimumi.

KQZ ka mbajtur një tjetër qëndrim, duke argumentuar se klasifikimi përfundimtar gjenerohej automatikisht nga sistemi. Por pikërisht mospërputhja mes këtij shpjegimi dhe gjurmëve të evidentuara gjatë shqyrtimit të procedurës është një nga çështjet që kërkon sqarim të plotë.

Pas ankesave të operatorëve të dëmtuar, KPP e rrëzoi klasifikimin e KQZ-së si të paligjshëm dhe kërkoi kthimin e procedurës. Por historia nuk u mbyll aty. Paralelisht, KQZ kërkoi penalizimin e operatorit “INSTANT.AL”, me pretendimin se kishte paraqitur dokumente të rreme për ekspertin Granit Gjana.

Edhe këtu, Agjencia e Prokurimit Publik nuk e pranoi versionin e KQZ-së si të mirëqenë. APP konstatoi se nga verifikimet e kryera, përfshirë skanimin e kodeve QR në dokumente, certifikatat dhe diploma rezultonin në emër të Granit Gjanës. Për këtë arsye, APP i kërkoi KQZ-së të kryente verifikime zyrtare pranë vetë kompanisë lëshuese “Alison” dhe të sillte prova të plota, të përkthyera, të noterizuara dhe të njehsuara me vulë të njomë. Në të kundërt, kërkesa për penalizim do të konsiderohej e paparaqitur.

Kjo e vendos KQZ-në në një pozitë edhe më të vështirë. Nga njëra anë, një procedurë ku oferta më e lartë mbetet në lojë pas eliminimit të rivalëve më të lirë. Nga ana tjetër, një përpjekje për të goditur njërin prej operatorëve të skualifikuar, por pa prova të mjaftueshme për APP-në.

Historia bëhet edhe më e ndjeshme për shkak të emrit që qëndron pas INTELISOFT. Gëzim Hoxha është pronar i kësaj kompanie, por edhe i shoqërisë “FIRST”, e përmendur në raportimet mbi dosjen e AKSHI-t si një nga përfituese të kontratave të mëdha publike në fushën e teknologjisë. Sipas raportimeve mediatike mbi këtë dosje, Hoxha ka deklaruar para hetuesve se kompania e tij kishte fituar një procedurë të përbashkët të AKSHI-t dhe AKSIK-ut me vlerë rreth 60 milionë euro. Kjo shumë dhe rrethanat e kontratave janë pjesë e raportimeve mbi hetimin dhe nuk përbëjnë në vetvete konstatim fajësie ndaj tij.

Emri i Hoxhës është lidhur në raportime edhe me “Durana Tech Park”, ku dyshohet për skema transferimi aktiviteti përmes subjekteve të reja dhe përfituesve realë të njëjtë. Edhe këto janë çështje të raportuara në kuadër të hetimeve dhe dyshimeve për kontratat publike të teknologjisë.

Në këtë pikë, përgjegjësia nuk mund të mbetet vetëm te një emër përdoruesi në sistem. Në krye të institucionit është Kryekomisioneri Ilirjan Celibashi. Edhe nëse dokumentet e deritanishme nuk provojnë se ai ka urdhëruar apo kryer ndërhyrjen, drejtimi i KQZ-së ka përgjegjësi institucionale për të shpjeguar publikisht kush kishte akses, me çfarë autorizimi, çfarë veprimesh kreu dhe pse një person jashtë KVO-së shfaqet në procesin e rivlerësimit.

Sepse nuk bëhet fjalë për një institucion dosido. Bëhet fjalë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, institucionin të cilit qytetarët i besojnë administrimin e procesit zgjedhor. Pikërisht për këtë arsye, një histori mbi aksesin e një zyrtari jashtë komisionit përkatës në një sistem elektronik të KQZ-së merr peshë shumë më të madhe sesa një konflikt i zakonshëm tenderësh.

Rasti ngre një pyetje legjitime që KQZ duhet ta sqarojë: nëse kontrollet e aksesit lejuan që një person jashtë KVO-së të kryente veprime në sistemin e prokurimit, çfarë garancish teknike dhe procedurale ekzistojnë që e njëjta gjë të jetë e pamundur në sistemet e tjera të institucionit?

Kjo nuk do të thotë se ka prova që sistemet zgjedhore apo votat janë cenuar. Por për një institucion që administron zgjedhjet, siguria e aksesit në sistemet elektronike dhe përcaktimi i qartë se kush mund të ndërhyjë në to janë çështje që prekin drejtpërdrejt besimin publik.

Vetë fakti që INTELISOFT–WOW DIGITAL kishte fituar më parë kontrata të KQZ-së nuk provon në vetvete shkelje ligjore. Por kur i njëjti bashkim kompanish merr kontrata të njëpasnjëshme për modulet e KQZ-së dhe më pas përfiton nga një procedurë ku rivalët më të lirë eliminohen pas një procesi të kontestuar pikëzimi, pyetja për konkurrencën bëhet e pashmangshme.

A kemi thjesht një operator që fiton vazhdimisht gara të rregullta, apo një treg që po mbyllet gjithnjë e më shumë rreth të njëjtëve emra?

Këtë herë përgjigjja nuk i duhet vetëm kompanive që humbën tenderin. I duhet publikut. Sepse kur në diskutim është KQZ-ja, besimi te mënyra si funksionojnë sistemet e saj vlen shumë më tepër se 43 milionë lekët e një tenderi./VNA

**Galeria fotografike ()**

3. Në datën 11.10.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit jar
›ftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

| | | | |
|---|---|---|---|
| *" NOAL " SHPK* | *0* | *leke* | *skualifikua* |
| *" Evolve Web Studio" SHPK* | *33.000.000* | *leke* | *skualifikua* |
| *" INSTANT.AL " SHPK* | *33.700.000* | *leke* | *skualifikua* |
| *BOE "INTELISOFT SHPK & WOW Digital SHPK"* | *40.823.564* | *leke* | *kualifikuai* |

Tiranë më 30.12.2025
Nr. 3752/__

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

**Data:** 30.12.2025

**Drejtuar:** BOE "INTELISOFT" sh.p.k me NIPT L91702001P me 30%
Adresa: Rr.233, Ap nr 3, Numri iPasurise 4/9+1-N3, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.
"WOW DIGITAL" sh.p.k me NIPT M01406022R me 70%
Adresa: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Tiranë.

**- *OE/BOE* me nënkontraktor**

***PO*** ☐ ***JO X***

***-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:***

**PO** ☐ **JO X**

Tipi i Kontratës:Sherbime.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedure e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, elektronike.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-52084-06-23-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Mirëmbajtja e moduleve ekzistuese të KQZ-së.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 24.06.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 33 datë 30 Qershor 2025.

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Buletini Nr. 90 datë 30 Dhjetor 2024** **Agjencia e Prokurimit Publik**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [Data] [Numri]____________________________

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE "INTELISOFT" sh.p.k. me NIPT L91702001P dhe "WOW DIGITAL" sh.p.k me NIPT M01406022R.

Vlera 2,820,000 (dy milion e tetëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka operator të skualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE "INTELISOFT" sh.p.k me NIPT L 91702001 P, adresa: Rr.233, Ap nr 3, Numri iPasurise 4/9+1-N3, Zona Kadastrale 8270, Tiranë dhe "WOW DIGITAL" sh.p.k me NIPT M 01406022 R, adresa: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Tiranë se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2,820,000 (dy milion e tetëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH /pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4, Tiranë 1007 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [nuk ka], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Drejtuar:
Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

BOE "INTELISOFT" sh.p.k. Me NIPT L91702001P.

Adresa: Rr.233, Zona Kadastrale 8270, Numri i Pasurise 4/9+1-N3, Ap nr 3, Tiranë.

"WOW DIGITAL" sh.p.k me NIPT M01406022R

Adresa: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Tiranë.

- OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X
Nëse po, të jepen dhënat ____________________________
(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X
Nëse po, të jepen dhënat; ____________________________
[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës:Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-33734-12-17-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Moduli për raportimin në kohë reale të aktiviteteve publike të insitucioneve shtetërore.

Data e Publikimit të Njoftimit te Kontratës në SPE: 19 .12.2024



KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:
-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1.BOE "Intelisoft" sh.p.k me NIPT L 91702001 P dhe "Wow Digital" sh.p.k me NIPT M 01406022 R.
Vlera 5,825,000 (pesë milion e tetëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka operator të skualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE "INTELISOFT" sh.p.k me NIPT L 91702001 P, adresa: Rr.233, Ap nr 3, Numri iPasurise 4/9+1-N3, Zona Kadastrale 8270, Tiranë dhe





"WOW DIGITAL" sh.p.k me NIPT M 01406022 R, adresa: Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Tiranë se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 5,825,000 (pesë milion e tetëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH /pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4, Tiranë 1007 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [nuk ka], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.




## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 19 Shtator13:08

**“Mbështetje të plotë nga SHBA”/ Berisha: Lufta kundër narkoshtetit dhe trafiqeve, në fokus të takimeve tona**

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka deklaruar se gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara ka gjetur mbështetje p&eum...

POLITIKE 19 Shtator12:53

**“E kanë në dorë kryeministrin”/ Berisha: Balluku, Agasi e Beqiri janë “padronët në krim”. Çfarë i tha Lubia në takim Ramës kur SPAK kërkoi arrestimin e saj**

Kryetari i PD-së, Sali Berisha në një bashkëbisedim me qytetarët në rrjetet sociale u ndal te skandalet e bujshme të qeveri...

POLITIKE 19 Shtator12:34

**“Narkoshteti dhe drejtësia si armë politike”/ Berisha tregon çfarë përcolli në takimet në SHBA: Diaspora, e gatshme për çmontuar këtë regjim**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka folur për vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku mori pjesë n&...

POLITIKE 18 Shtator23:10

**Reforma Territoriale, Braçe nxjerr bllof qeverinë: Nuk është diskutuar me deputetët**

Deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe, deklaroi se ende nuk është bërë një diskutim i plotë për Reformë...

POLITIKE 18 Shtator21:45

**Protesta/ Qytetarët nuk e kursejnë deputeten e PS-së: Sara Mile, ke të fala nga burgu i Elbasanit**

Gjatë lëvizjes nëpër kryeqytet, protestuesit kanë përsëritur thirrjet kundër qeverisë, ndërsa një prej sl...

POLITIKE 18 Shtator21:04

**“Edi Rama frikacak do të çojmë ty në SPAK”, protestuesit vijojnë marshimin në Tiranë: Ju erdhi fundi!**

Pas përfundimit të fjalimeve, protesta e 111-të kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama ka vijuar me marshim në Tiranë. Qy...

POLITIKE 18 Shtator20:52

**“Organizatorë dhe protestues të jemi një”, qytetarja në revoltën kundër Ramës: Vendimet duhet t’i marrim bashkë, protesta të kalojë në nivel tjetër**

Qytetarë të shumtë ishin prezent në protestën e 111-të para Kryeministrisë. Një protestuese u shpreh se në kë...

POLITIKE 18 Shtator20:36

**Revolta kundër Ramës/ Protestuesi: 50% e popullatës në kufirin e varfërisë! Pensionistët marrin 100 mijë lekë në muaj për punën e një jete**

Në revoltën e 111 kundër , protestuesi renditi një sërë argumenteesh kundër qeverisë, dhe kryeministrit Edi Rama. Gjat&...

POLITIKE 18 Shtator20:17

**“Korrupsion, pastrim parash e fshehje pasurie”/ Gazment Bardhi: SPAK ende pa asnjë kërkesë për heqjen e imunitetit të Ballukut**

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar lidhur me mungesën e një kërkese nga Prokuroria e Posa...

POLITIKE 18 Shtator20:08

**“T’i japim besën njëri-tjetrit!”/ Arben Kola thirrje të rinjve: Bashkohuni për Shqipërinë e Re deri në shporrjen e Edi Ramës, koha është tani!**

Aktivisti Arben Kola u ka bërë thirrje të rinjve që të bashkohen në protestën kundër qeverisë, duke kërkuar nj...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

**"Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...**

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 18 Shtator

**VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...**

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

BOTA 18 Shtator

[Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet ...]

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...

INVESTIGIME 18 Shtator22:42

[“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit]

Jemi në Tiranë, në rrugën e Durrësit, aty ku një apartament është kthyer në “mollë sherri” dhe ka ...

## video



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.